



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	117/21
Nr. i sq. / Br. st	-22-
Data: / Datum	27. 05. 2021
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -IV- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 29 PRILL 2021**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë duke filluar në orën 10:20.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:
Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ymeri, Agim Krasniqi, Basri Menxhiqi, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Faton Shabani, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Ilir Krasniqi, Fitim Halili, Ismet Haxhizi, Kushtrim Hyseni, Haxhiz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rustemi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Syla, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrovë, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Miljan Bojković.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës z.Afrim Namani, drejtorët e drejtive komunale, përfaqësuesit e KFOR-it dhe zyrtar tjerë kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrjen e vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Para diskutimit të rendit të ditës kuvendit nderoj me një minutë heshtej jetën dhe veprën e të ndjerit Dr. Hajrullah Sarçi, drejtor i Spitalit të Qytetit të Vushtrrisë, i cili ndërroj jetë para disa ditëve.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-pasi përshëndeti të pranishmit, ceku se edhe pse nga viti 2019 ku ka filluar shtrimi i rrjetit të ujësjellësit nëpër lagjet dhe fshatrat e ndryshme, prapëseparapë ujë nuk, kjo gjendje është në shumicën e fshatrave të Komunës së Vushtrrisë si: Druar, Reznik, Stanoc i Epërm, Samdrexhë, Smrekonicë, Sfaraçak, Dumnicë dhe fshatra tjera. Pyetja e tij për Drejtorin e Shërbimeve Publike ishte se a kanë planifikuar vendosjen e pompave në mënyrë që të gjithë qytetarët të gëzojnë një të drejtë elementare për të pasur ujë të pijes. Mandje gjatë punimeve për instalimin e rrjetit të ujësjellësit, janë prerë dhe dëmtuar shumë rrugë të cilat akoma nuk janë rregulluar dhe pyeti a pritet rregullimi i këtyre rrugëve të dëmtuara nga kompanitë që i kanë kryer punët. Gjatë punimeve në fshatin Stanoc i Epërm në lagjen Ajvazi, kryetari i komunës ka premtuar se do të bëhet rregullimi i kanalizimit, nëse përfaqësuesit e lagjes bëjnë rregullimin e një pjese të atij kanalizimi, lagjja ka kryer obligimin e vetë, kurse premtimi i kryetarit të komunës nuk është realizuar kurrë, andaj ajo lagje sot e asaj ditët është mbet pa rregullim të kanalizimit. Pastaj

potencoj çështjen e pagave jubilare të mësimdhënësve dhe punëtorëve tjerë të arsimit e cila është e rregulluar me kontratën kolektive të nënshkruar në mesë të Sindikatës së Arsimit dhe Ministrisë së Arsimit në vitin 2017 e përtërirë në vitin 2021, në ne nenin 35 pika 8 të kësaj kontrate thuhet: punëtorët anëtarë të SBASHK-ut në vitet jubilare të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar në vlerë prej:

Për 10 vjet të përvojës punës në vlerë të 50% të një page bazë;

Për 20 vjet të përvojës punës në vlerë të 75% të një page bazë;

Për 30 vjet të përvojës punës në vlerë të një page bazë;

Për 40 vjet të përvojës punës në vlerë të 150% të një page bazë.

Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, ku i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterieve të nenit 8 dhe bëhet me rastin e 7 marsit të çdo viti. Andaj edhe pse ka kaluar kjo datë në vitin 2021 nuk është bërë ekzekutimit i këtyre pagesave për shumë mësimdhënës të shkollave të Komunës së Vushtrrisë. Për këtë pyeti Drejtoreshën e DA-së, se përsë nuk është bërë ekzekutimi i këtyre pagesave edhe pse mjetet për paga jubilare kanë qenë të planifikuara. Tutje adresoj një shqetësim të studentes Agnesa Haradinaj, e cila në muajin shkurt ka filluar praktikën në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa më datën 23 prill 2021 të njëjtën e thërret në zyrë e ti drejtori i DSHP-së z. Shkëlzen Xhaferi i cili i thotë se do ti ofroj një kontratë pune por me kushtin që të largohet nga LVV-ja dhe të anëtarësohet në subjektin politikë LDK, sepse siç ai deklaron se në zgjedhjet e fundit në Stanoc të Epëm LDK ka humbur zgjedhjet, dhe se atje kjo e fundit nuk ka asnë aktivist të shkolluar që është shumë i nevojshëm. Andaj nga të cekurat më larët vlerëson se një qasje e tillë e kushtëzimit politik nga ana e drejtorit është e dëmshme dhe e papranueshme dhe e njëjta duhet të ndryshohet, pasi LVV ashtu qysh i ka fituar zgjedhjet e përgjithshme do të fitoj edhe zgjedhjet lokale në vjeshtën e këtij viti.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-pyeti drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit lidhur me zbatimin e një vendimit lidhur me banesën kolektive. Ku kësaj drejtorie i ishin bartur përgjegjësitë për të ndërmarrë veprime për sanimin e gjendje së rënd që është në atë objekt ku po rrezikohen 19 familje që banojnë atje nga rrëzimi i pullazit. Nga muaji janar kur është nxjerr ky vendim nuk ka informacione se çfarë ka ndodhur me atë objekt dhe a është iniciuar diçka për këtë problematikë, krejt kjo sepse ai objekt është në gjendje tepër të rënd, e ndërsa komuna me çdo çmim dëshiron ta rrënoj objektin e ish-gjykatës ndërsa për objektin që paraqet rrezik për banoret nuk i intereson fare.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-më qëllim të sqarimit të opinionit publik, ceku se përfolët lidhur me pronën tek ish motel "Vicianumi" dhe vendimit për dhënien e kësaj prone në shfrytëzim, për këtë njoftoj qytetaret se kuvendi komunal nuk ka marr vendim për dhënien në shfrytëzim të asaj prone. Në atë hapësirë shihet se të gjitha objektet që ishin atje janë rrënuar, ndërsa pyeti se kompania punën kryerëse a ka marrë leje për rrënimin e atyre objekteve në Drejtorinë e Urbanizmit, dhe nëse po atëherë i fton qytetarët që mos të merren me kuvendin e komunës, pasi që ajo pronë është në pronësi të Ministrisë së Drejtësisë. Për sa i përket vendimit për rrënimin e objektit të ish-gjykatës komunale, shihet qartë tash më se me këtë vendim po bëhen lojëra politike mes kryetarit të komunës dhe Lëvizjes Vetëvendosje. Nga vlerësimet e bëra nga MAPL-ja del se ky vendim është i kundërligjshëm, edhe pse arsyetimi i atij vlerësimi të mistrisë nuk del se është mjaftueshëm i qartë. Ai potencoi se referenca në atë vendim është e gabuar pasi që vendimi me referencë 22/2019 i datës 31.01.2019 me të cilën janë dhënë në shfrytëzim prona komunale në shfrytëzim për 99 vite, dhe më pas është marrë një vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 22/2019, andaj pika 3 e vendimit për rrënimin e objekti të gjykatës komunal është antilogjor, ku thuhet se me këtë vendim shfuqizohet pika 1.3 e vendimit paraprak 22/19 pikë kjo që tashëm ka qenë e shfuqizuar. Më tej sa i përket vendimit për themelimin e komisionit për

dhënen në shfrytëzim të pronës komunale në Parkun Industrial në Lumadh, mund të thuhet se edhe ky vendim është i jashtëligjshëm, pasi që neni 17 i Ligjit për dhënen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, përcakton shumë saktë që komisioni i cekur duhet të jetë në përbërje prej 5 anëtarëve dhe atë 2 nga kuvendi, 2 nga qeveria komunale dhe 1 nga shoqëria civile, por që kryetari i komunës ka qitur në lajthim kuvendin duke u thirre kinse në Ligjin për Zonat Ekonomike dhe e ka bërë këtë komision prej 7 anëtarëve. Në fund ai kërkoj nga kryesuesi i kuvendit dhe kryetari i komunës që këtë dy vendime të sillen në kuvend për rishqyrtim, pasi që një gjë të tillë e kërkon Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa lidhur me vendimin tjetër për Parkun Industrial ekziston baza që ky vendim të kthehet i kundërligjshëm pasi që përbërja e komisionit është në kundërshtim me ligjin, kurse në përbërje thuhet se një kompani ka përfituar pronë komune në Parkun Industrial, ndërsa në vendim nuk ekziston fare kjo është tepër shqetësuese dhe e rrezikshme sidomos kur kihet parasysh fakti se kjo është potencuar nga një anëtar i kuvendit dhe i komisionit për pronës z. Ymer Haradinaj.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-në referim të parafolësit të tij, ceku se bëhet fjalë për konsorciumin IFA që është përfituese e pronës në hapësirë prej 50 ari në Parkun Industrial në Lumadh, kjo nuk është shpifje por është realitet.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se është mirë që të zhvendoset vëmendje nga fshati Stanoc, pasi që kryetari i komunës përpos që dërgoj atje një fabrikë të tekstilit, vendosi që të ndërtoj atje edhe një çerdhe, bibliotekë dhe muze. Tani mire kishte me qenë të orientohemi pak edhe nga fshati Smrekonicë, pasi ata po thonë qe munden edhe ata ti bëjnë 500 nënshkrime për tu ndërtuar më pas një çerdhe. Tutej njoftoi se në fushatën elektorale në 2017 Xhafer Tahiri kishte premtuar rregullimin e rrugës “Lutfi Mustafa” në fshatin Smrekonicë ku gjendja e saj është tepër e keqe dhe përbri saj gravitonjë 12 shtëpi, ndërsa në anë tjetër një militanti të LDK-së, përpos rrugës ia instaluan edhe ndriçimin publik, kjo tregon se çfarë qeveria po na udhëheq.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-ngriti shqetësimin e saj lidhur me rrezikimin e bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës Växjö – Suedi, bashkëpunim ky i cili e ka kaluar dekadën dhe janë përfituar miliona euro donacione nga ky bashkëpunim. Më datën 26 mars 2021 është mbajtur takimi i fundit në platformën online, dhe nga kjo del se për teke të kryetarit të komunës dhe kryesuesit të kuvendit është rrezikuar ky bashkëpunim, për faktin se takimet e këtij lloj planifikohen shumë më herët, ndërsa ditën e atij takimi kryetari i komunës zgjedhë që të dal në fshatrat e komunës dhe të postoj foto nga atje në rrejtët sociale duke anashkaluar kështu takimin që vlerësohet se është i rëndësishëm për komunën. Ajo deklaroi se do të angazhohet qoftë edhe e vetme por edhe me këshillat tjerët që ky bashkëpunim të mos ndërpritet pasi është i rëndësishëm për komunën. Kryetari i komunës, është anëtar i këshillit drejtues gjë e cila nga fillimi nuk ka qenë në rregull pasi që këshilli drejtuese i këtij projekti i raporton kryetarit të komunës. *Andaj lidhur me këtë çështje ajo kërkoj informatë me shkrim nga kryetari i komunës për atë se çfarë mendon kryetari i komunës, se a duhet të ndërpritet apo të përfundoj projekti i bashkëpunimit mes Komunës së Vushtrris dhe Komunës Växjö të Suedisë.* Po ashtu përgjigje kërkoj edhe nga kryesuesi i kuvendit se a është akoma anëtarë i këshillit drejtuese lidhur me këtë projekt.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-sqaroi se për çështjen e vendosjes së bashkëpunimit dhe binjakëzimit mes Komunës sonë dhe komunave tjera vendos kuvendi i komunës dhe njoftoi se në vitin 2011 ka qenë koordinatori i parë i kësaj marrëveshje i deleguar nga ish kryetari Bajram Mulaku, dhe asnjëherë nuk ka qenë kundër marrëveshjeve bilaterale të komunës sonë e aq më pak me Komunën e Växjö ku atje e kemi edhe një bashkëpunëtor bashkatdhetarin tanë Islam Islami i cili ka dhënë shumë për Komunën e Vushtrrisë. Pastaj njoftoi se ditën e takimit ka qenë jo mirë në

kuptimin shëndetësor për shkak të zërit, dhe shtoi se ai nuk është që ky bashkëpunim të ndërpritet, por çështja është se ai ka menduar se me përfundimin e koalicionit qeverisës nuk do të jetë pjesë e këshillit drejtues.

Melihate Basholli-Latifi, anëtar i kuvendit-tha se ky bashkëpunim mes këtyre komunave, nuk lidhet me përfundimin e mandatit, andaj ceku se bashkëpunimi duhet të vazhdohet pavarësisht se kush udhëheq me komunën sepse kjo do të ketë efektet e mira deri në anëtarësimin tonë në Bashkimin Evropian si shtet.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-pyeti se çka ka përfituar Komuna e Vushtrrisë nga bashkëpunimi me Komunën e Växjö të Suedisë.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit- sqaroi se përfitimet më të mëdha nga ky bashkëpunim kanë qenë në fushën e arsimit dhe të shërbimeve publike dhe ai ka qenë kryesisht në baza të asistencës teknike dhe shkëmbimit të përvojave.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-paraqiti sqarime hyrëse duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit. Lidhur me çështjen u ujit të pijshëm sqaroi se shtrimi i rrjetit është projekt tre vjeçar, ndërsa tani në rajone të caktuar siç është ai i Dumnicës është duke u punuar në ngritjen e stacioneve pompuese. Rregullimi i rrugëve duke i kthyer në gjendjen e mëparshme nga prerjet për vendosjen e kanalizimit do të filloj shumë shpejt pasi tani veç se është nënshkruar kontrata përiparim të rrugëve. Lidhur me peticionin për objektin kolektiv në sheshe, njoftoi se DUMM ka themeluar një komision profesional, për vlerësimin e atij objekti ndërsa kuvendi e ka adresuar këtë çështje në Drejtorinë e Emergjencave. Nga paramas dhe parallgaira del se kostoja përenovimin është rreth 40,000.00 €, ndërsa drejtoria ka në dispozicion vetëm 2000 € që mjaftojnë vetëm përrregullimin e çatisë dhe ullukëve. Lidhur me këtë çështje ka të interesuar një investitor i cili dëshiron të investoj përmes përqindjes në bashkëfinancim. Për sa i takon pronës së ish-Hotel Vicianumit ekziston një kontratë mes Ministrisë së Drejtësisë Shërbimit Korrektues së Kosovës një investitori të quajtur "Erisi" ajo parcelë është dhënë në shfrytëzim për 15 vite, Drejtoria e Urbanizmit ka dhënë leje përrënimin e atyre objekteve përkategorinë e parë dhe të dytë, ndërsa ka leje të përkohshme të ndërtimit që është lëshuar konform procedurave ligjore

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se rregullimi dhe kthimi në gjendjen e mëparshme i rrugëve që janë dëmtuar nga vendosja e kanalizimit, nuk është bërë deri më tani sepse dheu dhe materialet tjera duhet të pushojnë në afat deri në 6 muaj ashtu që të fitohet qëndrueshmëria. Pra tendencia që të fajësohet ish drejtori i DSHP-së z. Refik Maloku është spekulative dhe politike, sepse ai ka qenë drejtor me përvojë, ndërsa ky drejtori aktual fare nuk ka përvojë dhe e dimë fare mire se si ka ardhur në këtë pozitë. Apeloi që mos të dezinformohet opinion nga ana e drejtorit të DUMM-së.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-tha se nuk qëndron konstatimi se duhet të pritet afati prej 6 muajve përmblidhje e vrimave, në rrugë, por ato duhet të mbushën, pastaj të ngjeshën mirë dhe më pas duhet të riasfaltohen.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së- tha se ata të cilët po akuzojnë është mirë të na tregojnë se si është ardhur në pozitë drejtori i DSHP-së, e jo të shpifin. Lidhur me çështjen e Komisionit të pronën në Parkun Industrial në Lumadhdh, ceku se ai vendim është aprovuar në kuvend. Dhe se komuna e Vushtrrisë është prej komunave të vetme që ka themeluar një komision të tillë. Nëse shikohen komuna tjera sa i përket zhvillimit të procedurave për zonat ekonomike ato kanë veprua me zero transparencë. Pikërisht me qëllim të rritjes së transparencës kryetari i komuna e ka involvuar kuvendin, dhe ka marrë vendim për themelim të komisionit edhe pse një gjë e tillë nuk ka qenë obligim në saje të Ligjit për Zonat Ekonomike. Në fund tha se duhet hequr praktika e keqe

e kthimit nga dy herë e vendimeve në kuvend, sepse kjo është keqpërdorim i kuvendit, për faktin se nuk mund të lajthiten 35 anëtarë të kuvendit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se në bazë të Ligjit për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim, konkretisht nen 17 decidivisht përcaktohet se komisioni për pronë duhet ti ketë pesë anëtarë, në këtë rast ndryshtë shtetëve pruar dhe këtu ashiqare po shihet se kush po dezinformon. Çështjet të cilat po sillen para kuvendit shpejt e shpejt po tentohet të lajthitet kuvend dhe kështu të njëjta po kthehen si të kundërligjshme.

Gresa Muli, anëtarë e kuvendit-kërkoj që qeveria komunale serjozisht të merret me çështjen e sanitit të gjendjes në objektit në sheshe të qyteti pasi që ai objekt paraqet rrezik të madh për ata banor. Ajo shprehu gatishmërinë e saj që të merret edhe vet me këtë problematikë duke bashkëpunuar.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-kërkoi që propozimi i tij të futet si pikë e dytë në renditej në rendin e ditës, pasi që shihet se punëtoret e sigurimit dha pastrimit janë instrumentalizuar dhe shpërdoruar politikisht nga qeveria komunale.

Afrim Namani, nënkyryetar i komunës-tha se është vërtet i çuditshëm propozimi i anëtarit të kuvendit z. Ilmi Azemi, dhe shtoi se ky komisioni në përbërje nga Ilmi Azemi, Agim Bregaj, dhe Afrim Namani, ka funksionuar si është mesë miri dhe për gjithçka ka pasur konsultim dhe dakordim. Deri në fazën e fundit të zgjedhjes së drejtoreve të bordit nuk ka pasur probleme. Ndërsa në fund të këtij procesi ka qenë dakordim i komisionit që vlerësimet ti bëjmë në formë të veçantë përmes një formulari secili veç e veç dhe kur është filluar procesi i vlerësimit anëtar i komisionit Ilmi Azemi është tërhequr nga vlerësimi pa ndonjë shpjegim. Andaj ai propozoi që kjo pikë fare mos të hyj në rendin e ditës.

Në fund të debatit për rendin e ditës, Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me 29 vota "për" 2 vota "kundër" 1 votë "abstenim" aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 25 mars 2021;
 2. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit me numër të protokollit Nr.17/21 i datës 28.01.2021;
 3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar – mars 2021;
 4. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore;
 5. Shqyrtimi i petitionit të parashtruar nga Fitim Pllana;
 6. Shqyrtimi i Raportit janar – mars 2021 për të hyrat dhe shpenzimet;
 7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirimin nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzimin e hapësirave publike;
 8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirimin nga pagesa e taksave së mbeturinave për familjet me asistencë sociale në Komunën e Vushtrrisë;
 9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për përkrahje financiare të personave të prekur nga pandemia Covid 19;
 10. Shqyrtimi i Draft – statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtri;
 11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për transferimin e mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezervë në kategorinë e shpenzimeve kapitale;

12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 2 prill 2021;
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 16 prill 2021;
14. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 25 mars 2021;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 32 vota “për”, 2 vota të përbajtura aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 25 mars 2021.

2. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit me numër të protokollit Nr.17/21 i datës 28.01.2021;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-pas njoftoi se këtë propozim e ka përcjell me kohë dhe me shkrim tek anëtarët e kuvendit, shtoi se komisioni i tanishëm aksionarë nuk e ka kryer punën si duhet, dhe kësijo aksionarë i vetëm i Ndërmarrjes Lokale “Përparim” është Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë. Ky kuvend ka autorizuar në gjirin e vetë dy përfaqësues nga një përfaqësues nga qeveria komunale që në rastin konkret nuk mund ta vazhdoj më tutej mandatin sepse nuk është anëtarë i qeverisë anëtarë aktual dhe këtë e ka kërkuar nga qeveria komunale që ta zëvendësoj dhe nga kuvendi të zëvendësohet anëtarë i kuvendit i cili ka ra pre e politikës dhe ka qenë jo profesional dhe në vendimmarrjes objektive. Në rastin konkret ai është tërhequr nga komisioni sepse paraprakisht janë vendosur njerëz joprofesional të cilët rrezikojnë afarizmin e ndërmarrjes qysh në themelim dhe refleksioni do të jetë edhe në Komunën e Vushtrrisë për arsy se është aksionare në vlerën 100 %. Në konkursin e shpallur ka pasur njerëz të përgatitur, dhe tendencia e mbivotimit paraprakisht ka bërë që ai të tërhiqet si anëtar, sepse këta të tjerët nuk kanë qenë objektiv dhe kanë vepruar sipas direktivave politike. Krejt kjo ka rezultuar në probleme në vendimmarrje dhe rrjedhimisht vendimet e marra deri më tani janë jashtëligjore. Andaj bordi aktual është jo legitim dhe në asnjë rast nuk i iu janë përgjigjur komisionit të aksionarëve dhe kuvendit të komunës i cili është aksionarë në vlerë 100 % e aksioneve të kësaj ndërmarrje. Prandaj në bazë të gjitha këtyre të gjeturave dhe duke tentuar ta ruajmë stabilitetin e ndërmarrjes duhet medoemos të kemi njerëz profesional dhe jo njerëz të politikës, ndërsa veprimet deri më tani janë puro politike dhe në bazë të urdhreve të dhëna nga politika. Sa i përket punëtorëve të cilët janë instrumentalizuar dhe dezinformuar nga kryetari i komunës se problemi është tek kuvendi dhe se punëtoret do të mbisin pa paga kjo nuk qëndron dhe se përgjegjësia kryesore e realizimit të kontratave të punëtorëve është qeveria komunale dhe ftoj që të vazhdohen kontrata e tyre për arsy se kompania nuk është themeluar ende, është në probleme goxha të mëdha të cila i kanë krijuar më qëllim dhe jo profesionalizëm të këtyre dy anëtarëve të komisionit për të cilët kërkon të zëvendësohen.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se vërtet është një çështje e ndjeshme, dhe ndan shqetësimin e punëtorëve që gjenden në objektin e komunës e të cilët janë tepër të shqetësuar. Ajo për të cilën këta punëtor i sigurojnë si grup kuvendar i LVV-së është se do ta bëjnë më të mirën e mundshme që këta punëtor të kompanive të sigurimit dhe të pastrimit të jenë pjesë e ndërmarrjes lokale “Përparimi” që është pronë 100 % e Komunës së Vushtrrisë. Si grup i LVV-së janë vetëm duke i shikuar procedurat por asnjëherë nuk do të veprojnë në kundërshtim me interesat e punëtorëve të cilët janë dezinformuar dhe manipuluar nga ana e kryetarit të komunës. Andaj ai

është i mendimit që riprocedohet kjo çështje ashtu që të bëhen plotësim ndryshimet e nevojshme ligjore, mos të kemi interferim politikë dhe mos të monopolizohet kjo ndërmarije nga një parti politike si LDK-ja, kur dihet se ajo është partia më voleg në radhën e partive prirëse në Komunën e Vushtrrisë. Prandaj propozoi që të procedohet kërkesa e anëtarit të kuvendit Ilmi Azemi, që të shkohet me një komision gjithëpërfshirës dhe jo vetëm nga një parti politike.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-saktësoi se propozimi i tij është që të zëvendësohet anëtar i komisionit nga radhët e LDK-së, të obligohet kryetari i komunës të zbatoj ligjin ashtu që ta zëvendësoi anëtarin e komisionit nga radha e ekzekutivit komunal jo të jetë person politik.

Afrim Namani, nënkryetar i komunës-kërkoi një pauzë prej 15 minutash për konsultim dhe sistemim të disa gjërave.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-pasi i përshëndeti të pranishmit, vlerësoi se ta kundërshtosh zonën ekonomike në Lumadh me 800 punëtor, të kundërshtosh fabrikën e tekstilit në Stanoc me 60 punëtor <dhe sot të tentosh ta mbytesh ndërmarrjen Lokale “Përparim” akoma pa u themeluar dhe ngritur mirë është anomali dhe kjo bëhet vetëm nga ata anëtarë kuvendi të cilët nuk iu kanë mbetur asnjë copëz e parimeve dhe kjo po shihet por, ai i pyeti anëtaret e kuvendit se a ekziston Zoti për ta. E gjithë puna dhe mundi që është bërë deri më tani nga ekzekutivi komunal, për ta ngritur këtë ndërmarrje, është për keqardhje se si po tentohet që me ngritje dore të minohet kjo kompani, për të cilën nuk kanë pasur ide këtë anëtarë të kuvend për themelimin e saj përpos që e kanë votuar në kuvend dhe për më keq se kaq po tentohet të lihen rrugëve punëtore të cilët më herët ishin hequre nga mbrojtja dhe menaxhimi i komunës, tani që po ngitet ndërmarrja dhe po sistemohen punëtoret është e dhimbshme që anëtarët e kuvendit po veprojnë kësisoj në dëm të këtyre punëtorëve. Kontrata me kompaninë e sigurimit skadon me datën 15 maj 2021 dhe është vazhduar vetëm 3 muaj më qëllim që me mbërrit që këta punëtor të kthehen në ndërmarrjen “Përparimi”, andaj në momentin që sot prishet krejt ky proces qysh edhe është filluar me qëllim të keq bashkë LVV-ja me PDK-në, ky proces kthehet në zero dhe na duhen edhe një vit edhe a do të mund apo jo ti kthejmë këta punëtor në Ndërmarrjen “Përparimi”, më tej edhe tre muaj këta punëtor do të mbesin pa paga sepse nuk kemi kontratë dhe pikë e dyte kur të kthehet procesi në zero edhe njëherë vetëm me filluar me shkuar në procesin e vlerësimit të ligjshmërisë vendimi i sotshme do ti merr 15 ditë dhe kontrata do të skadojë e sot jemi me datën 29 prill ku i kemi edhe dy javë afat për të mbetur këta punëtor pa paga dhe duke bredh rrugëve dhe përsërit pyetjen drejtuar anëtarëve të kuvend se ekziston Zoti për ta, sepse parimet i ka para se nuk kanë fare. Tute shtoi se çka është gjithë kjo ngarendje për të shkatërruar çdo projekt që është në të mirë të qytetarëve, çka është gjithë kjo nguti e juaja për me shkatërruar çdo gjë të mirë që bëhet në këtë qytet, kujt po i pengon ndërmarrja “Përparimi” atyre të LVV-së po, dhe ceku se qëllimi është që të ndërrrohet komisioni i aksionarëve të formohet një komision i ri i cili do të shkarkoj bordin e drejtoreve, i cili është zgjedhur në formë të ligjshme, dhe konsekuenca e ngjarjes është që të themelohet një komision dhe bord i ri nga Lëvizja Vetëvendosje dhe PDK-ja si dhe një drejtor të ri politik nga këto dy subjekte politike. Më tej ai u betua në Zot se nuk e ka pasur ndërmend por tani e ka forcuar bindjen se do të kandidojë sérish për kryetar komune dhe do ti mund së bashku PDK-në dhe Lëvizjen Vetëvendosje dhe politikanët e kafeve të çajave do ti heqin nga kuvendi dhe do të mbeten veç në kafe të çajave. Politikanët që kanë marrë pagë nga kuvend për tri vite e gjysmës dhe nuk e kanë dhënë as edhe një ide që do ta përmirësonë jetët e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Kur kishte shpallur kandidaturën për kryetar komune kishte premtuar se do ta modernizoj Qytetin e Vushtrrisë dhe këtë e ka bërë, andaj në mandatin tjetër do ta modernizoj edhe këtë kuvend. Qytetaret e kanë vërejt qasjen e rrënimit të projekteve, qasjen e inateve personale, politike, ku dikush në orët e vona shënon një email dhe bëhen bashkë për shkatërrimin e ndërmarrjes

“Përparimi”. Qasja për ti ja vënë minat kësaj kompanie, do ketë konsekuenca të rënd për punëtoret duke i lënë ata pa paga dhe duke mos mundur as në të ardhmen të bëhen pagesat pasi që kontrata do të skadojë. Ka ardhur në krye të komunës, për ti zgjidhur aq sa mundet problemet e qytetarëve, edhe pse në rrugëtim mund të bëj gabime, por ajo se çfarë po pretendon të bëj kuvend sot është e turpshme. Për më shumë gjashtë muaj do të mbahen zgjedhjet lokale, dhe kuvendi me mandat të ri do ta zgjedh një komision të ri dhe rrjedhimisht një bord tjetër, por kërkoi që mos të preket tani ndërmarrja “Përparimi” pavarësisht se kush është duke udhëhequr me komunën. Ekziston një kategori e njerëzve që janë nihilist ata gjithçka të falin por jo edhe suksesin, soji i tyre tërë ditën rrinë nëpër kafe duke bërë broçkulla dhe gjenjeshtra dhe kurrë në jetën e tyre nuk e kanë bërë një punë për së mbari. Mos lejon të bëni këtë gabim sot, sepse kjo do të na kushtoj, sepse nga fillimi qëllimi i ndërtimit të ndërmarrje “Përparimi” ka qenë që punëtoret e sigurimit dhe të pastrimit të futen nënë ombrellën e komunës, punëtor të cilëve nuk iu është paguar trusi për dhjetë vite radhazi. Andaj nëse ka arsyeshmëri politike për këtë punë atëherë le të priten zgjedhjet lokale të cilat do të mbahen pas gjashtë muajsh, në të kundërtën mos vepron nëse vërtet keni ndonjë parim politik në interes të qytetarëve mos e shkatërroni këtë kompani. Andaj ai u betua se do të jetë aty për ti mundur politikanët e kafeve dhe spikeret e radiove ashtu që ti pensionojë politikisht.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-në replikë me kryetarin e komunës iu drejtua me fjalët se është spiker i radios, por jo sikur ai dhe vëllai i tij që janë aktor e që gjirojnë filma amator. Ai mikrofonin e mban me nderë dhe siguron ekzistencën e familjes në mënyrë të ndershme.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-duke parë tensionet në mbledhjen e kuvendit, apeloi tek dy taborët tek kryetari i komunës dhe Lëvizja Vetëvendosje që ti diskutoj shtruar paakuza, sharje e fyerje duke i kontribuar dialogut dhe mirëbesimit me njëri tjetrin sepse vetëm kështu mund të zgjidhim problemet e qytetarëve. Në anëtarët e kuvendit duhet të jemi shembull për qytetarin e jo të ngutemi në marrjen e vendime, sepse ata punëtor kanë hallë dhe duhet zgjedhur problemi i tyre. Ai ju bëri thirrej gjithë anëtarëve të kuvendit që të përbahen nga gjuha e urrejtjes dhe akuzave të ndërsjella.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se nuk dëshiron ta fyej askënd, por ka premtuar që do ta modernizoj qytetin dhe këtë do ta bëj. Pastaj shtoi se këto dy parti LVV e PDK i kanë numrat në kuvend dhe le ta marrin vendimin, por le ta dinë se kur punëtoret mbisin pa paga përgjegjësia do të jetë e tyre. Me 15 maj skadon kontrata dhe punëtoret do të mbisin rrugëve, kjo është e vërteta nëse është e kundërtë ai jap dorëheqje nga pozita e kryetarit të komunës. Ai ndihet i tensionuar sepse ndihet i tradhtuar nga anëtarët e kuvendit, kur e sheh që për inatet partiake minohet një projekt për të cilin me djersë ka punuar për afro dy vite. Krejt inati konsiston në atë se PDK ka kërkuar dy anëtar të bordit për të cilën nuk pajtohet kurrë sepse ata janë opozitë dhe rrjedhimisht nuk ju takojnë. Ai është i përkushtuar që tu gjendet një zgjidhje këtyre punëtorëve, ti cilët pushteti i kaluar i kishte lënë si tepricë teknologjike, për të cilët personalisht nuk di asgjë dhe cila parti i ka punësuar gjë kjo e cila nuk i ka interesuar kurrë. Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike i ka numrat në kuvend për ta marr një vendim të tillë por nëse veprojnë kësosoj le ta din se asnjëherë nuk do ta fitojnë pushtetin.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-vlerësoi se kur është fjala për këta punëtor, duhet ti lëmë anash interesat dhe inatet partiake, sepse interesit i qytetarit është më vlefshëm se sa interesit partiak dhe se nuk guxon askush por edhe ai nuk është i pajtimit që të merret një vendim i cili e dëmton interesin e këtyre punëtorëve. Ai bëri thirrej për tejkalimin e kësaj situate duke adresuar dhe përligjur interesat e punëtorëve.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se atëherë kur u informuar se po themelohet ndërmarrja “Përparimi” të gjithë jemi gjëzuar pasi po bëhet diçka e mirë për qytetin tonë. Andaj vlerësoi se askush nuk është i pajtimit që të merret vendim për dëmtimin e punëtorëve dhe kërkoj nga

kryesuesi i kuvendit që ta zbatoj rregulloren duke mbajtur rend sa i përket zhvillimit të punimeve të mbledhjes.

Afrim Namani, nënkyetar i komunës-kërkoi nga kuvendit që në afate prej dy muajve të mos merret asnjë vendim nga kuvendi ashtu që të mundësohet çështja e kontratës së punëtorëve mandej mund të merren edhe vendime për shkarkimin e strukturave të ndërmarrjes “Përparimi”.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-tha se në tërësi puna e komisionit të aksionarëve ka shkuar mirë, por më tej tek vlerësimi anëtarë nga radhët e PDK-së është tërhequr për këtë ai duhet të jap sqarime.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-saktësoi se ka dekluaruar se nuk ka mandat nga kryesia e partisë që bëhen emërimë të kundërligjshme në kompaninë “Përparimi”.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se i vjen shumë keq që gjendja ka ardhur deri në këtë pikë ku janë detyruar punëtorët që të sillen në kuvend. Pastaj shtoi se për këtë nuk ka faj LVV-ja, pasi ajo fare nuk ka pasur anëtarë në komisionin e aksionarëve sepse nuk ishte përkrahur nga ana e LDK-së. Pastaj duke ju referuar ofendimeve të kryetarit të komunës, shtoi se sipas tij ai mban mikrofonin në dorë sepse me atë punën mbanë familjen. Ai siguron ekzistencën familjare në mënyrë të ndershme pasi gruaja e tij është motër medicionale e cila rritë fëmijët në shtëpi, sepse ky nuk i ka mundësit sikurse kryetari i komunës i cili e avancon gruan e tij në institucionet më të rëndësishme të shtetit, andaj iu drejtuhet duke i thënë kryetarit që mos të ofendoj sepse është e pandershme dhe jonjerëzore. Ai pinë çaj më mirë se ti pinë hashash, ndërsa në kuvend merr pagë 200 € por jeton i lumtur dhe me nderë. Punëtorëve iu deklroi se dikush i ka manipuluar e keq informuar sepse nuk qëndron faji tek anëtarët e kuvendit, dhe u zotu se gjithçka që është në favorin e punëtorëve do të votohet sot, por kryetari i komunës e ka mbushur bordin e ndërmarrjes me militant të LDK-së, dhe kështu do ta sjellin në situatë juve kur vetë do ta kërkoni ndryshimin. Në fund ceku se për këtë çështje kryetari i komunës nuk ka mundur të merret vesh me Ilmi Azemin, andaj faj qëndron tek ata e jo te LVV-ja.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se faj më i madh i anëtarëve të kuvendit është se kanë votuar në rend të ditës një pikë për shkarkimin e komisionit të aksionarëve e rrjedhimisht edhe shkarkimin e bordit, e që pasojat e këtyre veprimeve do të jeni, mos mundësia e lidhjes së kontratës me ndërmarrjen “Përparimi”.

Basri Menxhiqi, anëtar i kuvendit-tha se duhet lënë anash politika dhe duhet përkrahen punëtoret e ndërmarrjes “Përparimi”.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-tha se është për keqardhje tendencia e kryetarit të komunës për të luajtur me ndjenjat e këtyre punëtorëve me të cilët bashkë ndjejmë thellë me gjendjen e tyre. Si grup i LVV-së janë që kjo çështje të ketë transparencë të plotë dhe që mos ta shndërrojmë këtë ndërmarrje publike në ndërmarrje politike. Andaj kërkoi nga kryetari i komunës që të bëj një zgjidhje për këta punëtor për një afat prej 3 deri në 6 muaj ashtu që mos të mbesin pa paga këta punëtor, ti vazhdoj kontrata e punëtorëve përfshirë afatin e cekur më lartë. Ajo kërkoi pauzë për konsultim.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se sa herë që Lëvizja Vetëvendosje shkakton kriza, kërkon që të gjenden zgjidhje. Procesi ka qenë krejtësisht transparent, dhe punëtoret nuk kanë pasur asnjë shqetësim deri më sot, kur sot është hi në rend të ditës shkarkimi i komisionit dhe rrjedhimisht bordi i drejtoreve, dhe kësisoj është vu në rrezik themelët e ndërmarrjes “Përparimi” andaj ai apeloj që kjo pikë të qitet në votim ashtu që shohin të gjithë se si po votohet për shkatërrimin e kësaj ndërmarrje.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-tha se ky nuk ka qenë i informuar që kjo pikë do të sillet në kuvend për shqyrtim, por edhe kështu ai në fillim të mbledhjes së bashku me asambliston Kushtrim Hyseni e votuan kundër që të futet në rend të ditës. Tani kur e sheh Xhafer Tahirin duke folur për

parime dhe duke moralizuar është për të ardhur keq. Pastaj ai ceku se e njeh shumë mirë Xhafer Tahirin, sepse ai është mashtrues i tipit A, sepse aty do të punësohen 60 punëtor dhe disa tjere do të mbesin pa punë, dhe shtoj se nëse dikush nga këta mbetet pa punë a do ti bashkëngjiten atij për të protestuar kundër Xhafer Tahirit. Për ta përkufizuar personalitetin e kryetarit prej një mashtruesi del fakti se që tri vite bashkë me LVV-në në Vushtri i kanë vjedhur qytetarin. Ai në paraqitjet publik në televizione e ka paraqitur Vushtrisë si qytet të çajit, ndërsa pak më herët i fyejti të gjitha kafe-çajtoret e Vushtrisë ndërsa më vonë tha se i ka subvencionuar ato, kjo tregon për konsistencën e këtij individi. Logjika e kryetari të komunës është paraja, shitja dhe blerja, andaj ai nuk ka të dejtë ti fajesoj anëtaret e kuvend për parime, për pos atyre që i ka blerë qoftë me para apo me ndonjë vend pune. Në vazhdim ai deklroi se sa herë që ka menduar se Xhafer Tahiri po pasurohet në kurriz të qytetarëve ai ka votuar kundër tij. Në rastin e punëtorëve të "Përparimit" edhe sikur ta dinë që kryetari i komunës do të bëhet milioner nuk voton kundër tyre, bile propozon që të rriten pagat e punëtorëve. Por ajo se çka duhet ta ketë vëmendjen është se ky proces është i komprometuar sepse dihet nga fillimi se do të punësohen militantët e LDK-së Fadil Bahtiri do të jetë kryeshek, Isak Krasniqi zyrtar kryesor financiar e kështu më radhë. A kërkoi transparencë në këtë proces dhe ceku se asnjëherë nuk do të votoj kundër interesave të këtyre punëtorëve.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se anëtar i kuvendit Lorik Maxhuni, sa here që ka folur për këto tri vjet është dëshmuar se nuk ka pasur të drejt. Ai e ka filluar procesin e themelimit të ndërmarrjes në fjalë me qëllimin më të mirë që ti ndihmoj punëtorëve që këta të bëhen punëtor shtetëror dhe tani ky proces është duke u finalizuar, kur duhet të nënshkruhet kontrata me ta, kontrata e komunës me ndërmarrjen "Përparimi". Nëse sot zgjidhet komisioni i ri i aksionarëve, siç propozoi LVV-ja dhe PDK-ja komisioni do ta shkarkoj bordin dhe rrjedhimisht nga kjo komuna nuk do të ketë me kënd të lidh kontratë dhe punëtoret do të mbesin pa paga, me këtë po shihet se kush po mashton. Koalicion i fshehtë i ka numrat në kuvend dhe le të urdhërojnë le ta shkatërrojnë ndërmarrjen por përgjegjësia do të bie mbi ta. Në bazë të Ligjit të Prokurimit, nga momenti i shpalljes së kontratës me vlera mbi 125,000.00 € procedurat tenderuese kërkojnë 100 ditë punë që ky proces tenderues të përbylltet. Andaj një votim sot i kuvend do ishte shkatërrues për punëtoret dhe ndërmarrjen. Në fund deklroi se të gjithë punëtoret e pastrimit dhe sigurimit do punësohen asnjë nuk do jetë jashtë kësaj ndërmarrje ndërsa me buxhet është paraparë edhe rritja e pagave të tyre, ndërsa nga sektori i menaxhimit të hapësirave publike, ai i mirëmbajtjes së banesave dhe parkingjeve parashihet të hapen edhe 100 vende të reja të punës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-tha se duke marr për bazë situatën e krijuar si dhe duke pasur parasysh pritjet e punëtorëve të ndërmarrjes "Përparimi", por edhe zotimin e qeverisë komunale, për ti vazhduar kontratat me kompanitë dhe punëtoret e sigurimit dhe pastrimit, e tërheqin propozimin për ndryshimin e komisionit deri në mbledhjen e ardhshme, me qëllim që ti jepet mundës vazhdimit të kontratave nga data 15 maj 2021.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se duke parë gjendjen e punëtorëve, që janë duke u keqpërdorur nga ane kryetarit të komunës, por edhe me qëllim që ti mundësohet hapja e lidhjes së kontratave, e tërheq propozimin e tij me qëllim të mbrojtjes së interesave të punëtorëve. Por megjithatë ritheksoj se është formuar një bord jo legitim dhe kryesuesi duke shfrytëzuar pozitën e tij në përbërje jo të plotë ka nënshkruar vendim të cila janë të kundërligjshme por që përbëjnë edhe tejkalim të kompetencave dhe autorizimeve të tij. Për këtë ai tri herë radhazi ka shkruar email dhe ka tërhequr vërejtjen e tij për shkeljet ligjore që po ndodhin në vazhdimësi, por nuk kishte marr asnjëherë përgjigje. Në rrethanat e krijuara po tentohet të gjuhet faji tek kuvendi, i cili e ka bërë më të mirën e mundshme, i cili në mënyrë unanime ka vendosur që ta themeloj këtë ndërmarrje dhe gjithherë do ta ketë përkrahjen e këtij kuvendi. Ai kërkoi nga qeveria komunale që ti plotësoi

kérkesat ligjore, që të vazhdohet aktiviteti i mëtutjeshëm i këtij komisioni dhe që formën ligjore të bëhet zgjidhja e duhur, sepse kjo ndërmarrje nuk është e asnjë partie politike po e qytetarëve, andaj tendencia për manipulim me punëtorët është e papranueshme, në këtë rast kryesuesi i komisionit nëse shkohet në procedura ligjore ai duhet të përgjigjet edhe penalisht për shkak të shkeljeve ligjore që ka bërë

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se grupi kuvendar i LVV-së gjithherë kanë qenë për ti mbështetur punëtorët sepse politika e tyre janë politika sociale, andaj si grup kuvendar kërkuan që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën tjetër, mirëpo duke marr garanci të plota nga kryetari i komunës dhe qeveria komunale që të gjithë punëtorëve të sigurimit dhe të pastrimit të iu garantohen kontrata gjashtë mujore. Pra pas nënshkrimit të kontratave gjashtë mujore të iu garantohet që asnjë nga këta punëtor të mos mbisin pa paga dhe më pas grupet kuvendare ti vazhdojnë politika e tyre i kanë në kuvendin e komunës. Tëtje duke parë se kjo qeveria komunale dhe kompania kontraktuese për disa muaj nuk iu ka dhënë gjysmën e pagës punëtorëve të pastrimit të shkollave të mesme ashtu që ata janë dëmtuar. Andaj nëse është ky kryetar komune që kaq shumë po trumbeton për mbrojtjen e interesave të punëtorëve. Prandaj pyeti kryetarin e komunës se përsë këtyre punëtorëve nuk iu keni transferuar gjysmën e pagës, dhe kërkoi që në pagën vijuese këtyre punëtorëve tu transferohet edhe gjysma tjetër e pagës që është mbetur në minus. Në fund deklaroj se gjithherë si grup kuvendar kanë qenë me punëtoret edhe atëherë kur e kanë themeluar ndërmarrjen "Përparimi" dhe garantoj se punëtorët nuk do të mbisin asnjëherë jashtë ndërmarrjes. **Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha** se i vjen mirë që subjektet politike LVV dhe PDK, kanë reflektuar dhe prapë po mundohen të fitojnë një grusht votash. Ai kërkoi nga kryetari i komunës që ta shfrytëzoj autoritetin e tij që punëtorëve aktual tu jepet përparësi në punësim në ndërmarrjen "Përparimi".

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se kérkon mirëkuptimin e qytetarëve për shkak të fjalorit dhe ngritjes së tonit të zërit gjatë mbledhjes së kuvendi, por po shihet se tërheqja e subjekteve politike, nga qëndrimi i tyre i mëhershëm dëshmon se ajo ka qenë e domosdoshme, sepse po mos të veprohej asi soj do të ishte punë e kryer shkarkimi i komisionit të aksionarëve. Faktet do të dalin se si këto subjekte janë marr vesh që vota e tyre ti përdorin për shkarkimin e komisionit në fjalë, por kjo është politike. Pastaj deklaroj se së shpejti komuna do të lidh kontratë me Kompaninë "Përparimi" për angazhimin e punëtorëve të sigurimit të objekteve dhe ata të pastrimit dhe u zotua se asnjë punëtor nuk do të jetë jashtë kësaj ndërmarrje të cilët aktualisht janë të angazhuar. Andaj askush nuk ka nevojë ta luan rolin e heroit, duke i shpëtuar ata, sepse ata e dinë nga fillimi që nuk do të largohen nga puna, sikurse nuk janë larguar as në të kaluarën sepse nuk ka vepruar politikisht dhe fare kjo çështje nuk i ka interesuar. Ditëve në vijim shumë shpejt do të zgjidhet drejtori i bordit, dhe komuna do të lidh kontratë me ndërmarrjen "Përparimi", dhe të gjithë këta punëtor do të kalojnë si punëtor të "Përparimit" dhe më pas ai është i mendimit që automatikisht krejt këtyre punëtorëve tu nënshkruhet një kontratë pune me "Përparimin", me secilin prej tyre, por për këtë çështje në respektim të ligjit duhet të vlej institucioni i konkursit, andaj ai propozon që kuvendi të harton dhe nxjerr një rezolutë dhe rekomandim për "Përparimin" që krejt punëtoret të pranohen në punë, edhe pse do të ketë vërejtje nga ana e auditorit, por ai është i gatshëm që pranoj këtë vërejtje por jo edhe shkeljen e ligjit, andaj rekomandimi është që mos të dilet më vonë e të thuhet se kryetari i komunës e ka shkelur ligjin. Andaj ai është që punëtoret nga data 15 maj të lidhin kontratë me ndërmarrjen "Përparime" në formë të përhershme ashtu siç e parasheh ligji. Ai i falënderoi dhe kërkoi falje ndaj punëtoreve për shqetësimin e bërë por kjo ka qenë e domosdoshme. Andaj ata që deri tash kishin ndërmend të prishnin këtë ndërmarrje nuk është mirë për ta dhe se kurrë nuk është vonë që pendohen për diçka që është e dëmshme, por nuk duhet luajtur me fatin e punëtorëve. Një

kompani kaq e rëndësishme sikurse “Përparimi” nuk është çështje e partive politike, sepse për politikë do të mund prapë në zgjedhje. Në fund propozoi që nxjerrët një rekomandim që iu jep prioritet të gjithë punëtoreve aktual që janë në listën e pagesë të nënshkruajnë kontratë me ndërmarrjen “Përparimi”. Kjo le të mbetet kështu sepse auditorit nëse konstaton shkelje përgjigja e strukturave të kompanisë duhet të jetë se kemi zbatuar një vendim të kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-tha se kjo është ide shumë e mirë, sepse kuvendi mundet të rekomandoj që të mbeten të gjitha këta punëtor në punë pa konkurs në ndërmarrjen “Përparimi”, por është përgjegjësi e kompanisë e bordit dhe shefit që të ekzekutoj këtë rekomandim. Andaj shtoi se grupi kuvendar i PDK-së është gjithherë i gatshëm të shtyj përpara secilën iniciativë për ti ndihmuar këtyre punëtorëve. Andaj i inkurajoj punëtoret që me ngulm të kërkojnë zbatimin e këtij rekomandim nga kompania të cilën kuvendi po e aprovon sepse kjo është një zgjidhje “fantastike” e cila nuk në është kujtuar më parë, por dijeni se kjo është një lojë e llojit të vet.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se herët a po vonë do të dal në shesh se ai ka pasur të drejt dhe në ndërdijken e kundërshtarëve politikë dihet se ka pasur të drejt sepse çdo projekti i tij ka qenë fantastike por që nuk pranohen për shkak të inateve politike.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të votohet në fund të mbledhjes ashtu që teksti i rekomandimit të jetë në formë të shkruar, që të jetë gjithçka e qartë, sepse është evident që kryetari i komunës është manipuluese dhe gjitha gjërat i bënë duke i imponuar, ashtu sikur ia kishte imponuar studentes së tij të cilën zvarrë e kishte futur në provim, dhe qysh më herët tentoj që ta sulmonte fizikisht kryesuesin e kuvendit për ta detyruar që të votoj kuvendi, ai vepron kështu edhe pse të gjithë e dinë se nuk ka të drejt.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-kërkoj që teksti i rekomandimit të bëhet nga një anëtar prej seilit subjekt politik por edhe nga përfaqësuesi i punëtorëve.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se bazuar në rregullat dhe rregulloren e kuvendit, pika e propozuar nga Ilmi Azemi anëtar i kuvendit duhet të votohet duke qartësuar se propozimi i tillë nuk përkrahet dhe në fund të mbledhjes ku të hartohet teksti i rekomandimit do të mund ta votojmë lidhur me atë rekomandim, ndërsa teksti i këtij rekomandimi duhet të jetë thjesht: kuvendorit i komunës i rekomandon qeveris komunale, kryetari të komunës dhe bordit të drejtorëve të Kompanisë “Përparimi” që më rastin e nënshkrimit të kontratës për sigurim dhe pastrim të janë të punësuar të gjithë punëtorët që janë listën e pagesave në momentin e nënshkrimit të kontratës

Në vazhdim kuvendi i komunës me 27 vota “për” asnjë “kundër” asnjë “abstenum” vendosi që propozimi i anëtarit të kuvendit z. Ilmi Azemi lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit Nr.17/21 të datës 28.01.2021, për zëvendësimin e Anëtarit të Komisionit të Aksionarëve pika 1.2. dhe plotësimin e Komisionit me një anëtar tjeter nga përbërja e Kuvendorit si dhe zëvendësimin e anëtarit nga ekzekutivi komunal dhe plotësimin e komisionit nga përbërja aktuale e ekzekutivit të hiqe nga rendi i ditës dhe të shtyhet për ndonjëren nga mbledhjet tjera të kuvendit.

Kuvendi në vijim themeloi komisionin për hartimin e rekomandimit në përbërjen si në vijim:

Melihate Basholli, PDK;
Agim Krasniqi, LDK;
Faton Shabani, LVV.

Melihate Basholli-Latifi, anëtar e kuvendit-para kuvendit lexoj rekomandimin e hartuar nga komisioni të cilin e gjeni në tekstin e plotës si në vijmë: *Kuvendi i Komunës i rekomandon kryetarit të komunës së Vushtrrisë, qeverisë komunës dhe menaxhmentit të ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi”, në Vushtrri, që deri më datën 15 maj 2021 të lidh kontratë pune, me afat të pacaktuar, me punëtoret e sigurimit dhe të pastrimit të cilët janë në listat e pagave të kompanive private, me të cilat komuna ka kontratë për këto shërbime.*

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi më sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 29 prill 2021, pas shqyrtimit të Propozim, të anëtarit të kuvendit z. Ilmi Azemi lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të kuvendit Nr.17/21 të datës 28.01.2021, për zëvendësimin e Anëtarit të Komisionit të Aksionarëve pika 1.2. dhe plotësimin e Komisionit me një anëtar tjetër nga përbërja e Kuvendit si dhe zëvendësimin e anëtarit nga ekzekutivi dhe plotësimin e komisionit nga përbërja aktuale e ekzekutivit pas, debateve dhe analizës së hollësishme kryetarit të komunës i parashtron këtë:

REKOMANDIM

Kuvendi i Komunës i rekomandon kryetarit të komunës së Vushtrrisë, qeverisë komunës dhe menaxhmentit të ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi”, në Vushtrri, që deri më datën 15 maj 2021 të lidh kontratë pune, me afat të pacaktuar, me punëtoret e sigurimit dhe të pastrimit të cilët janë në listat e pagave të kompanive private, me të cilat komuna ka kontratë për këto shërbime.

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, pas debateve dhe analizave të hollësishme, e ka shqyrtuar propozimin e cekur më lartë, dhe ka marr në konsideratë gjendjen e rënd ekonomike e sociale të qytetarëve, ka vlerësuar se është imediate, krijimi i kushteve për hapjen e vende të reja të punës. Kuvendi adreson shqetësimin dhe kërkesën e punëtorëve të kompanive privatet të sigurimit dhe pastrimit që të futen nënë ombrellën e ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi”, duke u avancuar dhe rregulluar statusi i punës së këtyre punëtorëve.

- 3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar – mars 2021;**
- 4. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore;**
- 5. Shqyrtimi i peticionit të parashtruar nga Fitim Pllana;**

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se meqë është shter debati për këtë temë në mbledhjen e kaluar, propozoi që për këtë pikë të delegohen përgjegjësitë në drejtorinë gjegjëse për përbushen e këtij peticioni.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-duke ju referuar një shkrimi të z. Fitim Pllana në rrjetin social facebook, i cili thotë se ishte takuar në fushatë zgjedhore me kryetarin e komunës dhe zyrtar tjerë të LDK-së, në një ndej të caktuar ku ju kishte dhuruar ca banane dhe hurma, dhe më tej ishte biseduar puna e tij dhe deklaron se më premtuan që do të merren me këtë punë dhe do ofrohet një zgjidhje, me rekomandimin e tyre ai thotë se e kishte nisur punën të cilit i kishte falënderuar, por më tej ishte shkuar inspektorati dhe ia kishte ndërprerë punën dhe tash ai pret zgjidhje. Kur ta shikoni se si shitet parimor kryetari i komunës, kur e marrim për bazë që Fitim Pllana qëndron në temperaturë në 40 gradë për ta siguruar ekzistencën, dhe ti bëhet këtij njeriu një mashtrim i tillë është gjëja më e ulët. Andaj kërkoi që këtij njeriu ti gjendet një zgjidhje duke e procedura këtë lëndë në drejtorinë gjegjëse.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit- vlerësoi se pasi që ky person ka filluar të korruptoj zyrtaret komunal, fare nuk është mirë që ti ndahet ajo pronë.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-tha se kryetari i komunës dhe zyrtaret komunal takohen me secilin qytetar që ka një hall dhe mundohen që ti zgjedhin atë hallë. Por nëse vendoset që kjo lëndë të dërgohet në drejtori atëherë nuk thuhet se i kemi bërë zgjidhje. Ai shtoi se dhënia e pronës në shfrytëzim është e rregullua me ligj dhe nuk mundemi ti shmangemi procedurave ligjore. Ai kërkoi nga të gjithë të fokusohen për gjetjen e një zgjidhje që është e mundshme e jo të merremi me politika populliste. Prej zgjidhjeve të mundshme ishte ajo e kryetarit të komunës për ti dhënë një kiosk që janë të vendosura afér objektit të komunës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se vet dërgimi i kësaj pike në kuvend është vetëm për të bërë politikë, por kryetari dhe drejtori e dinë mirë se kështu zgjidhja nuk bëhet. Pastaj krejt anëtarët e kuvendit janë për ti bërë zgjidhje Fitim Pllanës, por drejtoria është kompetente për ta gjetur formën dhe për ta gjetur zgjidhjen.

Berat Sadiku, drejtor i DUMM-së-tha se në atë hapësirë është filluar një ndërtim pa leje ndërtimore, dhe gjendet afér depos së patates në afërsi prej 1.5 metra që ka edhe hapje-derë në anën e atij objekti, propozimi i tij ishte të formohet një komision mikst kuvend –qeveri që shikohet mundësia për gjetjen e një parcele për këtë destinim sepse në pronën aktuale nuk mund tu dilet në ndihmë Fitim Pllanës.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se tani po shpërfaqet se qeveria komunale as që e ka ndërmend ti ndihmoj Fitim Pllanës, pasi të gjithë e dimë se për tu dhënë një pronë në shfrytëzim duhet të ndiqen procedura që i parashev ligji për dhënien e pronës në shfrytëzim. Por dihet fakti se iniciativa për këtë çështje i takon Drejtorisë së Kadastri e cila po shihet se nuk është e gatshme ti gjej zgjidhje Fitim Pllanës. Për bri asaj prone që Fitimi ka kërkuar të jepet në shfrytëzim, është duke u ndërtuar një objekt-depo tërësisht e panevojshme dhe ndërtim ilegal, që e kanë kundërshtuar të gjithë, sepse aty po pengohet qarkullimi i Qendrës së Handikosit, por edhe lëvizja e nxënësve, e tash po pamundësohet biznesi i një djali i cili ka punuar me sakrificë që disa vitet dhe e duan krejt komuniteti.

Agron Pllana, drejtor i DI-dha sqarime sa i përket fillimit të punimeve në atë pronë, që bëhet fjalë për një ndërtim pa leje, dhe pikërisht për këtë drejtoria ka urdhëruar ndërprerjen e punimeve. Lidhur me çështjen e dhënies së pronës në shfrytëzim janë procedurat e parapara ligjore.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-tha se është mirë të jepen sqarime se kush i ka premtuar Fitim Planës së do ti kryejnë punë lidhur me problemin e tij, dhe shtoi se drejtoria e Kadastri është kompetente që gjej zgjidhjen duke bërë ndarjen fizike të një ari tokë, por shihet se nuk ka iniciativë as vullnet për ekzekutivit për ta zgjidhur këtë problematikë. Në kjo pronë do të gjendej atëherë kuvendi është i gatshëm ta votoj këtë pikë. Ai tha se ata që kanë shti këtë person që të filloj këtë

ndërtim duke i vendosur pikat, ka vepruar tepër pandershëm se keni bërë që ky person të shpenzoj dhe ne gjithë i dimë kushtet e tij.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se parimisht jemi të gjithë që ky peticion të aprovohet, por disa bllokada po paraqiten nga qeveria komunale, dhe konsideron se duhet të merret një qëndrim lidhur me këtë peticion. Në këtë kontekst propozoi që rekomandimi i kuvendit të jetë si në vijim: autorizohet kryetari i komunës që duke u bazuar në ligj të jap pronë në shfrytëzim deri në një vit, të lidh kontratë dhe ti mundësohet, vazhdimi i aktivitetit biznesor Fitim Pllanës aty ku është. Në bazë të rregullores për pronë kryetari i komunës ka të drejt të jap pronë për periudhën më pak se një vit pa iu nënshtruar procedurave në kuvend.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se rruga ligue për ta zgjidhur këtë çështjen e Fitim Pllanës është, themelimi i një komisioni dhe trajtimi i kësaj çështje në bazë të Ligjit për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim dhe zgjidhja e dytë është që ti jepet në shfrytëzim njëra nga kiosket që gjenden në afersi të objektit të komunës, dhe kështu duke i dhënë një leje të përkohshme të punës, sepse për pak kohë do të bëhet zgjerimi i rrugës magistrale dhe aty do të jetë vështirë të zhvillohet një lloj i tillë i biznesit. Ai e kuption hallin e Fitimit, por komuna duhet të jetë e drejt dhe e barabartë me të gjithë.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së-kërkoi nga anëtarët e kuvendit që janë të gatshëm ti ndihmojnë Fitimit të janë konkret të na tregojnë vendin, numrin e parcelës, listën poseduese, sipërfaqen dhe afatin e dhënies në shfrytëzim të pronës ku do të vendoset objekti i personit në fjalë parashtrues të kërkesës. Në bazë të ligjit në fuqi, lista e pronave duhet të shpallet në faqen zyrtare të komunës, ku më pas ftohen qytetarët të konkurrojnë për ato prona, por nuk mundet dikujt apriori ti jepet prona duke ishmangur këtë procedura.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-duke e plotësuar propozimin e tij shtoi lidhja e kontratës në bazë të rregullores komunale për më pak se një vit, sipërfaqja $6 \times 12 = 72\text{m}^2$, parcela kadastrale P-70202043-00110-3, në këtë pronë është bërë edhe kopja e planit nga zyrtarët e kadastrit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se edhe nëse e dërgojmë rekomandimin tek kryetari i komunës ai nuk mundet në kundërshtim me ligjin të jap pronë në shfrytëzim. Dhe shtoi se në fushatë nuk është dashur ti premtohet kur dihet fakti se si jepet prona në shfrytëzim, por është dashur ti tregohet drejtë e jo të mashtrohet për një grusht vota. Por megjithatë janë disa prona që drejtoria i ka futur në listë, dhe nëse Fitimit i pëlqen ndonjë pronë mund të konkurron dhe në afate shkurtër do të mund tij jepej në shfrytëzim.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi më sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 29 prill 2021, pas shqyrtimit të kërkesës –peticionit të parashtruar në emër të z. Fitim Pllana, për caktimin e një lokacioni, gjegjësisht gjetjen e një parcele për vendosjen e një objekti-kiosk (montazh), që lidhet me ushtrimin e veprimtares së tij biznesore, pas, debateve dhe analizës së hollësishme drejtorisë së lartë shënuar i parashtron këtë:

REKOMANDIM

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë parimisht e aprovon peticionin e parashtruar nga z.Fitim Pllana dhe i rekordon Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që të zhvilloj

proceduar e nevojshme ligjore, për gjetjen e një lokacioni-parcele, ku do ti mundësohej zhvillimi normal i aktiviteti biznesor i z.Fitim Pllana.

Pas analizës së gjendjes Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, obligohet që të sjell një propozim para kuvendit për aprovim final, lidhur me gjetjen e kësaj parcele kadastrale.

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, pas debateve dhe analizave të hollësishme, e ka shqyrtuar peticionin e cekur më lartë, dhe ka vlerësuar se është imediate që z.Fitim Pllana ti gjendet një zgjidhje për caktimin e një lokacioni që do ti mundësonte ushtrimin e veprimtarisë së tij biznesore.

6. Shqyrtimi i Raportit janar – mars 2021 për të hyrat dhe shpenzimet;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 1 votë “kundër” aprovoj Raportin janar – mars 2021 për të hyrat dhe shpenzimet.

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirimin nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzimin e hapësirave publike;

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se edhe ky vendim është në kuadër të masave lehtësuese nga ndikimi i pandemisë covid-19 në ekonomin e komunës, efekti i të hyrave vetanake është afér 100,000.00 € efekti ekonomik i ndihmës është i njëjtë sikur ato tu jepeshin bizneseve.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 1 votë “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale të dhëna në shfrytëzim dhe hapësirave publike në Komunën e Vushtrrisë.

2. Lirimi nga pagesat e taksave dhe qirasë komunale për pronat e dhëna në shfrytëzim dhe shfrytëzim të hapësirave publike në Komunën e Vushtrrisë do të zgjasë nga data 1 janar deri më 31 dhjetor 2021.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

8. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirimin nga pagesa e taksave së mbeturinave për familjet me asistencë sociale në Komunën e Vushtrrisë;

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se janë afër 1400 familje me asistencë sociale në Komunën e Vushtrisë, dhe ato do të lirohen nga taksa komunale e mbeturinave në vlerë prej 4.80 €, ndërsa kostoja totale e efektit në hyrat e komunës është afër 78,000.00 €. Kjo është një masë tjetër lehtësuese për qytetarët tanë me gjendje të rënd socio-ekonomike, sidomos në kushte e pandemisë covid-19. Ndërsa një lajm i mirë është që këtë vit është rritur inkasimi për 14,000.00 € më shumë nga taksa e mbeturinave.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 1 votë “kundër” vendosi me sa vijon:

- 1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, familjet me asistencë sociale të Komunës së Vushtrrisë.**
- 2. Vendimi për lirimin nga obligimi i pagesës së takës për shërbimet e mbeturinave bëhet si rezultat i rëndimit të gjendje sociale të familjeve që përfitoj nga skema sociale si pasoj e pandemisë covid-19 e njojur si corona-virus.**
- 3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**
- 4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe fillon të prodhoj efekt juridik nga data 01 janar 2021 deri më datën 31 dhjetor 2021.**
- 9. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për përkrahje financiare të personave të prekur nga pandemia Covid 19;**

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se ky propozim-vendim është jo serioz, nga qeveria komunale, me të cilin po pretendohet që të prekurve nga covid-19 tu ndahen nga 50 €, ndërsa ne paraprakisht kemi marr një vendim tjetër i cili është votuar në mënyrë unanime nga kuvendi, e për të cilin asnje veprim deri me tanë nuk është ndërmarr në zbatimin e tij nga ana e qeverisë komunale, edhe për kundër faktit se qytetarët përballënn me skamje dhe vështirësi në sigurimin e mjeteve përbarnë. Ai më të vërtet nuk e kuption qasjen e propozuesit se çka në të vërtet po pretendon të arrin përfakt se vendimet e kuvendit janë detyruar për qeverinë komunale, ndërsa tanë propozohet të fuqizohet ky vendim për të cilin nuk e di se përfarë matematikash apo kalkulime politike po bëhet, andaj një propozim të tillë nuk do ta përkrahi.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-këtë propozim-vendim, kur ishte marr para tre apo katër muajve e kishte kundërshtuar, ai dhe kryetari i komunës, tanë nuk e kuption këtë të fundit ndërrimin e qëndrimit.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-pyeti drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, se sa është kostoja financiare e propozimit të sjellë para kuvendit, si dhe sa qytetar do të mund të përfiton nga ky vendim.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-tha se përvendimit të parë ai ka qenë që të mbështeten vetëm ata që nuk kanë të ardhura dhe që janë në gjendje të rëndë ekonomike që të përkrahen me 150 deri 300 € dhe përkëtë qëllim kuvendi ka themeluar një komision i cili vetëm njëherë është takuar dhe më tej nuk është marrë me atë çështje prandaj vendimi ka mbetur pa u zbatuar. Ndërkohë gjatë

kësaj kohe kemi pranuar shumë kërkesa nga qytetare e prekur me covid-19 dhe për më qenë më të drejt me të gjithë që kanë qenë të infektuar me covid-19, është menduar që të ndahen nga 50 € për secilin dhe nuk do të ketë nevojë fare që ketë komision. Andaj të gjithë ata të cilët kanë qenë në listën e IKSHPK-së si të infektuar, do të mund ta mbushin një aplikacion në formë online, dhe pas verifikimit në Drejtorinë e Shëndetësisë do tu dalin nga 50 € në llogarinë e tyre bankare. Në komunën tonë kemi afér 3000 të infektuar me covid-19 dhe secili prej tyre ka të drejt të aplikoj, kostoja financiare e këtij vendimi do të jetë rreth 150,000.00 € që i bie $3000 \times 50 = 1500,000.00$. Kjo formë do të jetë shumë më e thjeshtë dhe aplikimi do të jetë online dhe në mënyrë krejt transparente.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se sipas kryetarit të komunës, faj kryesor është tek komisioni që nuk është zbatuar vendimi i kuvendit për përkrahjen e të prekurve me covid-19. Por vlerësoi se ajo çfarë po thotë kryetari nuk është fare e vërtet, sepse në vendimin e kuvendit thuhet që komisioni ka për obligim vetëm ti shqyrtoj aplikacionet dhe jo të merret me çështje tjerra të implementimit të atij vendimi, sepse vështirësitet në zbatimin e këtij vendim janë në çështjen se është problematike që të konstatohen të ardhurat për secilin përfituese.

Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-tha se është kundër këtij propozim-vendimi, dhe shtoi se zbatimi i vendimit të mëhershëm nuk bie në fajin e komisionit, sepse komisionit është dashur ti përgatitet materiali. Vendimi duhet të zbatohet pasi që këtë e presin qytetarët, dhe komuna përkatësish drejtoria duhet ti filloj procedurat për zbatimin e këtij vendimi.

Afrim Namani, nënkytar i komunës-tha se në takimin që ka mbajtur komisioni për të prekurt me covid-19, ai ka qenë në cilësinë e UD të Drejtorit të Shëndetësisë, dhe nga ai takim është parë se të gjithëve iu është ngut që ai të përfundoj sa më parë, ndërsa njërit nga anëtarët e komisionit iu është ngutur ti jap dorëheqje. Nga diskutimet është dal se do të jetë shumë vështirë që të vlerësohen aplikacionet.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se grapi kuvendar i PDK-së e mbështetë vendimin e aprovuar më herët i cili përcakton se: me vendim të kuvendit ofrohet përkrahja financiare për familjet e prekura nga pandemia Covid-19 të cilat janë përfituese të asistencës sociale, familjeve me gjendje të rëndë ekonomiko-sociale në shumë financiare prej njëqind e pesëdhjetë euro (150 €) deri në treqind euro (300 €), përkrahën familjet që nuk kanë të ardhura, ato me të ardhura më pak se treqind e pesëdhjetë euro (350 €) në muaj të Komunën e Vushtrrisë. Vendim do të ketë efekt retroaktiv nga muaji mars 2020, dhe fillon të prodhojë efekt juridik nga data 05 janar 2021. Ndërsa për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe jo komisioni kuvendar. Sa i përket verifikimit të të hyrave të familjeve ai propozon që në aplikacion të vendoset një deklaratë nënë betim ku thuhet se të hyrat e tyre nuk tejkalojnë vlerën prej 350 €, kësisoj përgjegjësia bie mbi ta.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-tha se nëse veç ky vendim mbetet në fuqi ajo do jetë e detyruar të jap dorëheqje pasi që nuk dëshiron të jetë pjesë e një komisioni ku do të bëhen padrejtësi qytetarëve duke ju kërkuar një mori dokumentesh. Tujte ajo duke ju referuar vendimit ku thuhet se Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të ketë për detyrë t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha aplikacionet, të vlerësojë gjendjen e familjeve që janë të prekura me pandeminë covid-19 dhe në bashkëpunim me komisionin për shëndetësi do të vendos përfituesit e subvencioneve. Nga kjo del se komisioni nuk ka përgjegjësi për të hartuar forma të aplikacioneve, por vetëm ti shqyrtoj ato. Më tej shtoi se është e papranueshme që një qytetar sikur kryetari i komunës që e ka kaluar covidin, të përfitoj ngashëm sikurse një qytetar me asistencë sociale. Andaj ajo propozoi që të bëhet një kategorizim i atyre që janë prekur nga ky virus ashtu

që të ndahan 150 € për familjet që kanë pasur të hospitalizuar, 150 € për familjet që kanë humbur anëtar të tyre si dhe 150 € për përfituesit me asistencë sociale.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-propozoi që të ofrohet përkrahja financiare për familjet e prekura nga pandemia Covid-19 për familjet që kanë pasur rastet të vdekjes së anëtarëve të tyre, për familjet anëtaret e të cilave kanë pasur gjendje të rënd shëndetësore (që kanë qenë të hospitalizuar), si dhe për familjet përfituese të asistencës sociale, në shumë financiare njëqind euro (100 €). Ndërsa kategoritë dhe peronat tjera mos të subvencionet fare.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit-në rekapitullimin e debatit ceku se vendimi duhet të jetë retroaktiv nga data e fillimit të pandemisë, subvencionet ndahan për familje në vlerë prej 100 € për tri kategori, familjet që kanë humbur anëtarët e familjes nga covid-19, të hospitalizuarit, dhe familjet përfituese të asistencës sociale, ndërsa përfituese do të janë vetëm personat që gjenden në listën e IKSHK-së si të infektuar.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 22 vota “për” të tjerët nuk morën pjesë në votim vendosi më sa vijon:

- 1. Me këtë vendim ofrohet përkrahja financiare për familjet e prekura nga pandemia Covid-19 për familjet që kanë pasur rastet të vdekjes së anëtarëve të tyre, për familjet anëtaret e të cilave kanë pasur gjendje të rënd shëndetësore (që kanë qenë të hospitalizuar), si dhe për familjet përfituese të asistencës sociale, në shumë financiare njëqind euro (100 €).**
- 2. Përfituesit e këtyre mjeteve financiare, mund të aplikojnë përmes formave online, apo në formë fizike në Komunën e Vushtrrisë konform dispozitive ligjore të përcaktuar me Rregulloren (KKV) Nr. 01/2018 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë.**
- 3. Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të sigurohen nga kategoria e subvencioneve në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**
- 4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**
- 5. Ky vendim do të ketë efekt retroaktiv nga data zyrtare e fillimit të pandemisë Covid-19, në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa përfitues do të janë vetëm personat që gjinden në listën zyrtare të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, që kanë rezultuar si të infektuar me corona-virus e njohur si Covid-19, të cilët i janë nënshtruar testit PCR.**
- 6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01.Nr.258/20 i datës 07.12.2020 që ka rregulluar të njëjtën çështje.**
- 7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

10. Shqyrtimi i Draft – statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtrri;

Mejreme Ismajli, anëtar e kuvendit-propozoi që tek nenin 14 paragrafi 2 i statutit të QKM-së të shtohet të shtohet nënë paragrafi 2.4 në tekstin si në vijim: Drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare të zgjedhët me mandat katër (4) vjeçar me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër.

Hajriz Mustafa, anëtar i kuvendit-adresoi shqetësimin e tij lidhur me shpalljen e një konkursi në QKMF, për pranimin e një juristi, ndërsa është shujtë një vend i një mjeku dhe pyeti se kjo është bërë me çfarë logjike kur jemi në kohë pandemie, dhe këtë duke ja shtuar faktin se një mjek kontrollon 30 patientë në ditë dhe shpëton një jetë dhe për këtë çfarë i duhen QKMF-së dy juristë, apo vetëm duhet ti bëhet dikujt një vend pune, për të cilin tashmë po dihet se kujt po i bëhet ai vend pune asistentes së kryetarit të komunës. Kjo është e papramueshme dhe e panevojshme sepse QKMF-ja e ka një juristë që është duke punuar.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se sa i përket nenit për rizgjedhjen e drejtorit të QKMF-së, ceku se kjo nuk bie në domenin e statutit pasi që kjo përcaktohet me Ligjin për Shëndetësinë forma e zgjedhjes dhe formën e konkurseve e përcakton ligji, dhe se statuti në asnjë formë nuk mund të jetë në kundërshtim me Ligjin për shëndetësinë. Në këtë fryshtë ky propozim nuk di sa është në fryshtë e ligjit dhe si i tillë duhet të tërhoqet.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se anëtarja e kuvendit e bëri një propozim të cilin duhet ta hedhim në votim nëse ai votohet bëhet pjesë e statutit nëse mbetet ashtu siç është, nëse eventualisht statuti bie në kundërshtim me ligjin atëherë vlen ligji. Por mandati i drejtorit të QKMF-së duhet të figuroj në statut.

Kuvendi me vota “unanime” aprovoj propozimin e anëtares së kuvendit znj. Mejreme Ismajli, për shtimin e një paragrafi në Statutin e QKMF-së, sa i përket mandatit të drejtorit të QKMF-së.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës-evokoj kujtime për doktorin e nderuar tashmë të ndjerin Dr.Safet Idrizin të cilin e humbëm në përballje me pandeminë covid-19, dhe që tash e tutej përtej ngjyrimeve partiake QKMF-ja do të bartë me nder emrin e Dr. Safet Idrizit.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoj Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Vushtrri.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për transferimin e mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezervë në kategorinë e shpenzimeve kapitale;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 1 votë “kundër” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të kuvendit me numër të protokollit Nr.66/21 i datës 25.03.2021 për Specifikimi i Projekteve Kapitale, ashtu që bëhet transferimi i mjeteve nga kategoria e shpenzimeve rezervë në kategorinë e shpenzimeve kapitale si në vijim:

1.1.Infrastruktura Publike(18184) projekti:

1.1.1.“Rindertimi i rrugëve me infrastrukturë ”

1.1.2. Fondi 10 shuma 100,000.00 €

1.1.3. Fondi 21 shuma 30,000.00 €

2. Bujqësi (47024):

2.1.“Ndërtimi i kanaleve kulluese në Lummadh dhe Dumnicë e Ulët”

2.1.1. Fondi 10 shuma 30,000.00 €

2.1.2. Fondi 21 shuma 21,000.00 €

2.2. Rregullimi i shtratit të lumenjve në Studime, Maxhunaj dhe Dumnicë e Mesme”

2.1.1. Fondi 10 shuma 60,000.00 €

2.1.2. Fondi 21 shuma 23,000.00 €

3. Shërbimet e Shëndetësisë Primare:

3.1.“Vendosja e rrethojave në QKMF Vushtrri”

3.1.1. Fondi 10 shuma 30,000.00 €

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtorit tjera kompetente komunale.

5. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetën (15) ditë pas protokollimi në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 2 prill 2021;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 1 votë “kundër” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit, e datës 2 prill 2021.

13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 16 prill 2021;

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-ndanë mendimin se mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të datës 16 prill 2021 ka kaluar në mënyrë të jashtëligjshme dhe këtë edhe ministria gjegjëse do ta konfirmoj si të tillë. Dhe pyeti kryetarin e komisionit të pronës në Parkun Industrial në Lumadhdh, lidhur me pikën 1.22 të vendimit, ku ceket kompania 7 vëllezërit SH.P.K e cila figuron

në emër të Nasuf Zhegrovës, e cila në ARBK është po me këtë pronarë, për të cilën kompani deklroi se është në emër të axhës së tij dhe se e njëjta asnjëherë nuk ka aplikuar për të marr pronë në Zonën Ekonomike në Lumadh, andaj diçka e tillë është propozuar dhe hartuar si fiktive dhe e paqëndrueshme, kjo duhet të rishikohet. Lidhur me këtë ai deklroi dhe u zotua se nëse kjo nuk tërhiqet dhe nuk kërkojë falje publike, do ta padisin komunën për këtë veprim që e kanë bërë komisioni në fjalë edhe për vendimin që është aprovuar edhe për këtë procesverbal.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-paraqiti vërejtje sa i përket procesverbalit të datës 16 prill 2021, konkretisht në faqen 3, vërejtje të cilat u inkorporuan, në procesverbal, referencë keni procesverbalin e datës 16 prill 2021. Ai pretendon se ka redaktim të procesverbalit si rezultat i presonit tek zyrtari kompetent për mbajtjen e procesverbalit nga ana e kryetarit të komunës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit-tha se që në mbledhjen e parë kur është shqyrta propozim-vendimi për dhënien e pronës në shfrytëzim në Lumadh, ka kërkuar që emrat e kompanive dhe të pronarëve përfituese të pronës të evidentohen në propozim-vendim, kjo nuk ka ndodhur më qëllim të krijimit të mjegullisë. Dhe nga shikimi që ka bërë në ARBK, del se përfituese ka edhe vëllezër të punëtorëve të komunës. Ndërsa nëse del i vërtet deklarimi i anëtarit të kuvendit z.Ymer Haradinaj se një kompani ka aplikuar ndërsa prona i është dhënë dikujt tjetër kjo është akoma më e rrezikshme.


Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-kërkoi që të konstatohet në procesverbal të konstatohet se mbledhja kanë marrë pjesë 19 anëtarë të kuvendit 18 kanë votuar "për", ndërsa 2 anëtarë të kuvendit kanë marrë pjesë në votim duke "abstenuar" edhe pse kanë pasur konflikt interesit.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-përsëriti se diskutimi i tij nuk është përfshirësi plotës, dhe ka pasur redaktim të tij andaj kërkon të plotësohet. Mandej shtoi se ajo mbledhje ka qenë e censuruar pasi që nuk është transmetuar live, por është plasuar më vonë në faqen zyrtare të komunës tek pas përfundimit të saj për këtë ai kërkoi që peronat kompetent të japid përgjegjësi.

Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 22 vota "për" 1 votë "kundër" aprovoj Procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës, mbajtur më 16 prill 2021 më vërejtjet e paraqitura më larët.

Mbledhja përfundoi në ora 15:28.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit

